

P.nr.548 /07

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për krime të rënda- Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri, antarët e trupit Beqir Kalludra dhe Albina Rama, me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B.O. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së, F.P. për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pzetës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, I akuzuari B.H.për shkak të veprës penale Shpërdorim I pozitës zyrtare ose I autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, I akuzuari D.Sh.për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose I autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, tani Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamentit Për Krime të Rënda PP.nr.224-7/07 te dt.11.10.2007 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e të akuzuarve B.O.me mbrojtësin e tij Av. B. P.; F.P.me mbrojtësin e tij Av.M. H.; B.H.me mbrojtësin e tij Av.D. R., D.Sh.me mbrojtësin e tij Av.H. H., me prokuroren e shteti Dulina Hamiti, ne seancën verbalo-publik me dt. 16.01.2017, publikisht merr dhe shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

TË AKUZUARIT:

- 1. B.O.** nga i ati L.dhe e ema A., i vajzerise H., i lindur me *data e lindjes...* në P., ku dhe tani jeton, rr. “...” i martuar, baba i katër fëmijëve, me profesion economist, menaxher-pronar i sh.p.k l. P., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
- 2. F.P.**nga i ati R. dhe e ema V. i vajzerise S., i lindur me *data e lindjes...*në fshatin B. KK-M. ku dhe tani jeton rr. p.n. i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion doktor i Ekonomisë, tani i punësuar në Universitetin Privat – k., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 3. B.H.** nga i ati H. dhe e ema R., i vajzerise z., i lindur me *data e lindjes...*në f.sh. P. KK-V., tani me vendbanim në P. rr... Llam ... Banesa nr..., I martuar, baba i një fëmii, me profesion Economist dhe Jurist i diplomuar, i punësuar në D. e K., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. D.SH. nga i ati I. dhe e ema G. i vajzerise R., i lindur me *data e lindjes...* në Pejë ku dhe jeton në rr. nr...., ka të kryer fakultetin Ekonomik dhe Juridik, punon në kompaninë D-K. në P., i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ndaj të akuzuarit **B. O.**,

Konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së.

REFUZHET AKUZA

I- SE: Me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme në pikën Doganore "Dheu i Bardhë" KK.Gjilan, me dt.28.05.2005, ka paraqitur mjetet-paisjet në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë, ku këto paisje i ka paraqitur si mjete për prodhimin dhe paketimin e qumështit, e në fakt këto paisje-makina i ka përdorë për prodhimin dhe paketimin e langjeve .

- me çka kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Ndaj të akuzuarit **F. P.**

Konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së.

REFUZHET AKUZA

II. SE: Si shef i ekipës së kontrollës së jashtme, pranë Shërbimit Doganor, është ngarkuar me shqyrtimin e lëndës-Zhdoganimin e importit të paisjeve-makinave të bëra nga ana e subjektit ekonomik "L." me datën 28.05.2005, deri me sot nuk është bërë zhdoganimi i importit të lartëcekur edhe pse më datën 10.03.2006, Njësia për vlerësim me origjinë ka lëshuar vendimin nr.45/06, në bazë të cilit vendim subjekti ekonomik "L." duhet të ngarkohet me dogan dhe TVSH.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Shpërdorimi i pzohtës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Ndaj të akuzuarit **B. H.**

Konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së.

REFUZHET AKUZA

III. SE: Si shef i Njesisë së kontrollës së jashtëm pranë Shërbimit Doganor, deri me datën 13.04.2006, njësia e tij ka qenë e ngarkuar ta shqyrtojë-zhdoganoj importin e paisjeve-makinave të bëra nga ana e subjektit ekonomik "L." të datës 28.05.2005, zhdoganimi i paisjeve-makinave të lartëcekura, nuk është bërë deri më sot edhe pse me datën 10.03.2006, Njësia për vlerësim dhe origjinë, ka lëshuar vendimin nr.45/06, e në bazë të cilit vendim subjekti ekonomik "L." duhet të ngarkohet me doganën dhe TVSH.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Ndaj të akuzuarit **D.Sh.**

Konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së.

REFUZHET AKUZA

IV. SE: Si shëf i Njësisë së kontrollës së jashtme pranë Shërbimit Doganor, prej datës 13.04.2006 deri më datën 31.12.2006, njësia e tij ka qenë e ngarkuar ta shqyrtojë-zhdoganonjë importin e paisjeve të bëra nga ana e subjektit ekonomik "L." të datës 28.05.2005, zhdoganimi i paisjeve-makinave të lartëcekura nuk është bërë deri em sot, edhe pse em datën 10.03.2006, Njësia për vlerësim dhe origjinë ka lëshuar vendimin nr.45/06 e në bazë të cilit vendim subjekti ekonomik "L." duhet të ngrakohet ngarkohet me doganën e TVSH.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së.

- Sepse prokurorja e çështjes ka heqë dorë nga ndjekja penale.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Përfaqësuesi ligjorë i Doganës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasuroro - juridike udhëzohet në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me dt. dt.11.10.2007 ka ngritur aktakuzë PP.nr.224-7/07 kundër të akuzuarit B.O. për shkak të veprës penale Keqërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së, të akuzuarit F.P. për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, të akuzuarit B.H.për shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, të akuzuarit D.Sh. për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, dhe i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurit ti shpall fajtor dhe ti dënojë sipas ligjit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor me datën 16.01.2017, ku në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit Dulina Hamiti, ka theksuar se me provat të administruara gjatë seancave gjyqësore si dhe me ekspertizën e ekspertit financiar R. B., është konstatuar se me veprimet e të akuzuarve në fjalë nuk është shkaktuar dëm në buxhetin e Kosovës, dhe as Shërbimit Doganor. Prokurorja në fjalë ka shtuar se i pandehuri B.O. i ka përmbushur të gjitha obligimet doganore ndaj shërbimit doganorë qka është vertetuar edhe me ekspertizën financiare , me rastin kur është konstatuar se nuk është shkaktuar ndonjë dëm as buxhetit të Kosovës , e as shërbimit doganorë . Nga shkresat e lëndës shihet që kemi të bëjmë me një procedurë administrative e cila ka zgjatur për tri vite derisa ka ardhur te përcaktimi final i obligimeve doganore , por poashtu shihet se obligimet doganore janë përfunduar. Nga kja arsye prokurorja e shtetit tërhiqet nga aktakuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurve B.O. për shkak të veprës penale Keqërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së, F.P.për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, B.H.për

shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, D.Sh. për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së , sepse nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar . Këtë vendim prokurorija e ka marrë pas analizës së detajuar të ekspertizës financiare dhe poashtu pas analizës së të gjitha provave që egzistojnë në shkresat e lëndës .

Gjykata, pas tërheqjes së prokurores se shtetit nga aktakuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurve ne fjalë, këtë çështje penale e konsideroi si të përfunduar dhe mori aktgjykim refuzues në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së.

Vendimi për udhëzimin në kontest civil, gjykata e kamarr në bazë të nenit 463 par.3 të KPPRK-së,

Vendimin për lirim nga shpenzimet gjyqësore për të kauzuarit , përkatësisht vendimit që shpenzimet e procedures penale paguhen nga mjetet buxhetore , gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij atkgjykimi.

**-GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr.548 /07, të dt. 16.01.2017**

**Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit-gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.